

*Specialist (SOC 1, 24/7*3 Turne)/Sektori i Monitorimit dhe Reagimit të Incidenteve Kibernetike (SOC 1 & SOC 2), Drejtoria e Qendrës Operacionale - CSIRT, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.*

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008, "Për nënshkrimin elektronik" i ndryshuar, ligjit nr. 107/2015 "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara", i ndryshuar, ligjit nr.2/2017 "Për Sigurinë Kibernetike", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.141, datë 22.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe punonjësve në disa institucione të administratës publike", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.763, datë 12.12.2022 "Për caktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes së AKCESK", i ndryshuar, urdhrit të Kryeministrit nr. 32, datë 16.03.2023 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike", i ndryshuar, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, shpall konkurrimin për 5 (pesë) vende të lira pune në pozicionin:

- **Specialist (SOC 1, 24/7*3 Turne)/Sektori i Monitorimit dhe Reagimit të Incidenteve Kibernetike (SOC 1 & SOC 2), Drejtoria e Qendrës Operacionale - CSIRT, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

- Përbush detyrat funksionale në zbatim të legjislacionit në fuqi, për fushën e veprimit të Autoritetit, si dhe atë për ruajtjen e të dhënave personale;
- Raporton tek eprori për rastet e mosrespektimit të standardeve të sigurisë dhe propozon masa për rregullimin e situatës;
- Ndhmon me zhvillimin e planeve të reagimit ndaj incidenteve, rrjedhave të punës dhe procedurave standarde të funksionimit;
- Shënon incidentet dhe alertet në raport ditor duke evidentuar nëse janë zgjidhur ose janë ende në proces investigimi;
- Krijon dhe rishikon planet dhe raportet mujore mbështetur në analiza;
- Kryen në mënyrë proaktive kërkime të trafikut të rrjetit të pajisjeve dhe aktivitetit të sistemit duke kërkuar aktivitete të dyshimta (procese të dyshimta);
- Merr pjesë në trajnimet periodike të ekipit të Qendrës së Operacioneve të Sigurisë.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

Arsimi: Niveli minimal i diplomës "Bachelor" në Teknologji Informacioni/ Inxhinieri Kompjuterike/ Inxhinieri Informatike/ Inxhinieri Telekomunikacioni/ Inxhinieri Elektronike/ Shkenca Kompjuterike/ Informatikë Ekonomike.

Përvoja: Të ketë të paktën 1 vit përvojë pune në profesion. Përbën avantazh eksperiencë e punës në fushën e Teknologjisë së Informacionit, nga të cilat minimalisht 6 muaj në fushën e sigurisë dhe/ose monitorimit të rrjeteve apo sistemeve dhe/ose sigurisë.

Aftësitë: Përvojë në monitorimin e rrjetit, analizën e incidenteve dhe përdorimin e mjeteve të specializuara të sigurisë; Të kenë aftësi të shkëlqyera të komunikimit dhe dokumentimit, si dhe aftësi të mira zgjidhje-problemi dhe zgjidhje të shpejta në situata të kërcënuara; Në organizim, komunikim dhe prezantim; Njohuri të mira të gjuhës angleze.

FUSHA E NJOHURIVE:

Kandidatët do të intervistohen mbi fushën e njohurive si më poshtë:

- Teknikat e sulmeve kibernetike dhe aplikacioneve që përdoren për këtë qëllim;
- Njohuri mbi protokollat e rrjetave kibernetike;
- Njohuri mbi metodat e sulmeve kibernetike;
- Njohuri mbi aplikacionet dhe platformat që përdoren për Sigurinë Kibernetike;
- Njohuri mbi fushën e sigurisë së informacionit;
- Vlerësimin e dobësive dhe sigurinë e rrjetit.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (IV-2)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 04.10.2023, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, në adresën: Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I, Tiranë ose në adresën e e-mailit: burimet.njerezore@cesk.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim;
- CV (sipas formatit europass në gjuhën shqipe);
- Fotokopje të diplomave që disponon dhe listës së notave;
- Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Fotokopje të dëshmive të gjuhëve të huaja;
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- Të paktën një letër rekomandimi.

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.